

FEMRA SHQIPTARE NË RRËFIMET E UDHËTARËVE TË HUAJ

VALBONA KARAKAÇI

Departamenti i Letërsisë, Seksioni i Komunikimit, Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër, Shqipëri
Email: valbonakarakaci@yahoo.co.uk

Hyrje

Më 1927, revista *Drita*, një ndër më të njohurat e kohës, nën drejtimin e publicistit patriot Lumo Skëndo, merr nismën për ndriçimin e disa prej shënimeve (ditarë, kujtime, rrëfime etj) të të huajve që kishin udhëtuar nëpër Shqipëri, në fund të shek.XVIII-fillim të shekullit të XIX. Shënimet e nxjerra në dritë, në mënyrë të përmbledhur për publikun e gjerë, nuk shquhen për erudicion, por sjellin atmosferën e kohës dhe një numër të dhënash të rëndësishme për historiografinë, etnografinë e antropologjinë shqiptare, kryesisht përmes stilit ditar dhe epistolar. Vlerës faktike, si burim i drejtpërdrejtë informacioni për studime të mirëfillta shkencore, i shtohet edhe kontributi për krijimin e imazhit të shqiptarëve në botë dhe zgjimi i ndërgjegjes publike mbi ekzistencën e tij:

- *Kemi nevojë dhe detyrë të njohim opinionet e të tjerëve.*

Për botimet e shkrimtarëve kontemporanë kjo nevojë është akoma më urdhëronjëse: nuk jemi as në pol të dheut, as edhe në një çip të Afrikës a të Amerikës Jugore. Rrojmë në Evropë dhe okupojmë një pozitë midis popujve të qytetëruar, që kanë evoluuar në shkallët e përparimit. Ideja që kanë për ne influencon marrëdhëniet politike, kanë rëndësinë kryesore për zhvillimin tonë në qarkun e shteteve evropiane. Në kujtofshim se çdo libër e shtypur në mijëra ekzemplarë vete dhe pasuron arkivat e kancelarive, dirigjon gjykimin e përbotshëm si dëshmia e një dëshmitari para gjykatës, atëhere kemi detyrën aq shoqërore sa edhe patriotike, të çelim sytë dhe veshët mbi ç'thuhet, të këqyrim me vërejtje të madhe fotografinë tonë që ekspozohet në vitrinat e botës (Skëndo, 1927: 24-32, 89).

Më 1858 botohet në Paris, *Historia dhe Përshkrimi i Shqipërisë së Epërme ose i Gegërisë* (Hecquard, *Historia dhe Përshkrimi i Shqipërisë së Epërme ose i Gegërisë, konsull francez në Shkodër, Tiranë* 2008), aktualizim i një gjurmimi thuajse pesë vjeçar i ish konsullit francez Luigj lasinith Hekard (1814-1866),

gjatë qëndrimit të tij në Shkodër. Vepra në fjalë e tejkalon stilin përshkrimor të tregimeve të udhëtarëve dhe vjen me pretendime më shkencore, të paktën në burimet që adreson dhe analizën e fenomeneve, duke i strukturuar përshypjet në një nivel më objektiv e me një fokus më të gjerë. Ndryshe, nga përmbledhja e Skëndos, e cila ka në qendër kryesisht Jugun e Shqipërisë, Hekardi trajton jetën komplekse të Veriut.

Një tjetër autore që i shtohet rrallës së diplomatëve, ushtarakëve, tregtarëve, klerikëve, shkrimtarëve, gazetarëve, aventurierëve e pelegrinëve të pasionuar për Shqipërinë, është edhe Nowlle Rogger, pseudonimi i Hélène Pittard, bashkëshorte e bashkudhëtare e Eugèn Pittard, profesor e antropolog në Universitetin e Gjenevës, një ndër themeluesit e antropologjisë në Zvicër. Dy bashkëshortë ndërmorën udhëtimet e para në Ballkan në vitin 1899. Ndërsa profesori do të lidhej në vijim me Shqipërinë përmes funksioneve të tilla si i dërguar i Lidhjes së Kombeve, Konsull Nderi i Shqipërisë në Zvicër, themelues i Kryqit të Kuq Shqiptar, shkrimtarja e gazetarja e njohur zvicerane do ta përjetësonte këtë lidhje përmes një numri reportazhesh, esesh, skicash, shënime udhëtimesh të botuara në organet e shtypit zviceran gjatë viteve 1912-1924 duke u bërë e njohur edhe si publicistë dhe autore udhë-përshkrimesh, disa prej të cilave i gjejmë të përmbledhura në veprën *Nëpër Udhët e Shqipërisë* (u përgatit nga Ilda Poda, Tiranë 2008). Ajo që veçon shkrimet e Nowel Roge është stili letrar me të cilin ajo veshë simpatinë e jashtëzakonshme për popullin shqiptarë, përfshi këtu edhe femrën.

Sigurisht atmosfera që këto shkrime prezantojnë është kontekstuale e mjaft e ndryshme nga situata sot, porse rrënjët e një numri fenomenesh apo problemesh, zgjidhjen e të cilave ende nuk e kemi gjetur janë të verifikueshme në ndjesitë dhe faktet që këto shënime përcjellin. Ndërkohë, ajo që nuk ka ndryshuar është nevoja për të kuruar imazhin tonë si shqiptarë në sytë e botës, për të njëjtat arsye që na parashtron rreth gati një shekull më parë shqiptari i mirë Lumo Skëndo.

Punimi synon të prezantojë statusin social-ekonomik të femrës në fundin e shek XVIII-gjysmën e parë të shek XIX diktuar si kulturë të jetuari, porë kjo me sytë e të huajve që kanë kaluar nëpër Shqipëri në këtë periudhë e sjellë përmes veprave të cituara më lart. Një numër treguesish vijnë në formën e të dhënave cilësore, duke synuar nivelin e argumenteve që rreken në fund të fundit të japin në nivel kronologjik shpjegime mbi situatën në të cilën gjendet femra shqiptare sot dhe sfidat me të cilat ajo duhet të përballet.

Statusi i femrës në shoqërinë shqiptare, në gjurmët e pasojave dhe ndikimeve të tij

Në shumë prej shënimeve të mbledhura nga Lumo Skëndo, përshkrimet e udhëtarëve ndalen edhe tek statusi i femrës shqiptare tharmuar nga *rregullatorët e kohës: Kanuni apo sjelljet e trashëguara në Shqipëri*, të nënrenditura këto (veçanërisht kur flitet për femrën) në një grup më të gjerë kulturor: *bota Orientale* duke tërhequr vëmendjen se Shqipëria nuk do të mund të zhvillohet pa u emancipuar *gruaja e veçanërisht edukuar ajo*. Formulimi *bota Orientale* nuk na duket të jetë më i sakti i mundshëm pasi formalisht Shqipëria ishte pjesë e Perandorisë Otomane, por një numër dokesh e zakonesh, sjelljesh e mentalitetesh, që prekin edhe femrën, janë pjesë e kulturës autentike shqiptare e një pjesë janë të huazuara.

Kështu Bartholdy (L.S.Bartholdy, *Udhëtim në Greqi bërë në vitet 1803 dhe 1804*, Paris 1807) ndonëse vlerëson se janinotët janë më të mirët e grekëve, të mësuar, me rrojtje dhe sjellje të mirë, i klasifikon gratë e tyre si orientale e për rrjedhojë pa *asnjë edukatë, asnjë arsim*.

John C. Hobhouse (Hobhouse, 1813: 65), shoqëruesi i Bajronit në Shqipëri, flet për *edukatë* dhe jo *edukim* në kuptimin e arsimimit, e cila formësohet sajë rolit që gruaja mbarte në shoqëri aso kohe. Ai shprehet se “gratë e tyre janë *pa edukatë* dhe *shikohen si kafshë*: punojnë çdo farë punimi dhe shpesh herë hanë të rrahur...” duke vijuar me rrëfimin e historisë së një djali, të cilit i ati i shkruante “Eja se të kam *kam blerë një grua!*”.

Ami Bouè (Bouè, 1840: 131) e përforcon këtë rol “shqiptarka s’është veçse një *skllave e të shoqit*; punimet e rënda e bëjnë që të vyshket, rrudhet shumë shpejt i digjet lëkura si edhe burrave. Shumë herë *burri edhe e rreh të shoqen...*”.

Përkundër këtyre dëshmimeve John Gordon (Gordon, 1927: 82) (i cili e vizitoi vendin tonë së bashku me të shoqen zonjën Cora, më 1925) e lidhte përparimin e vendit me atë të gruas: “I pari problem i përparimit, *përmirësimi i fatit të grave të tyre*, ishte aty përpara po askush nuk kujdesesh”.

Mirëpo ky lloj tharmi, nga ç’na rrëfen Hughes (Hughes, 1820: 92), nuk është thjesht një dukuri sociale, por edhe një bindje transhendale e cila mesa duket i bëhet mbështetje dukurisë. Në një prej udhëtimeve të tij, ky pat takuar Psalidhën, drejtor i shkollës së Janinës, i cili teksa e kishte ftuar për kafe mikun Hughes, i pat thënë se *gruaja është e djallit* dhe në iu dhëntë liri, do të abuzojë soje. Udhëtari londinez shpreh keqardhje për *ndarjen e grave nga shoqëria* dhe është kjo arsyeja pse kur njerëzit i rrëfejnë besim ajo e përkthen atë si akt nderimi, gjë që e gëzon më shumë se gjithçka tjetër.

Kjo ndarje shoqërore në disa rrethana është perceptuar nga udhëtarët edhe si *neutralizim i disa prej niveleve të identitetit të femrës bashkëshorte*. Kështu Gordon na rrëfen historinë e Selimit, hotelexhi nga Elbasani, i cili i pat treguar se po vinte në Vjenë për të vizituar *fëmijën* “...e kuptova se si mysliman që ishte (shprehet Gordon) nuk mund të thonte grueja ime, po *fëmija*”. Jo rrallë, gjuha na jep informacion të shtuar, në rastin në fjalë, rrëfimi mbi Selimin, në fakt është një perifraxim i çuditshëm i marrëdhënies grua-burrë, duke e eliminuar në disa rrethana vetë marrëdhënien, e cila thjeshtëzohet deri në marrëdhënien burrë-grua (e neutralizuar)-fëmijë (po t’i referojmë si të vërtetë ngjarjen që na rrëfen Gordon).

Përzjerja apo njësimi i identitetit territorial apo nacional me atë fetar apo kulturor ndodh rëndom në përshtypjet e udhëtarëve, ngase ata pa u thelluar regjistrojnë faktet dhe jo arsyet e tyre. I tillë është klasifikimi që Hekard i bën vajzave të reja, të cilat teksa i përshkruan nga pikëpamja e grupeve sociale i klasifikon (Hecquard, 2008: 263-264) në *turke* (kupto myslimane), *krishtiane* dhe *vajza të reja të maleve* (kupto më së shumti edhe krishtiane). Hekardi dukshëm veçon me simpati grupin e fundit sa i takon respektit që ato gëzojnë: mundësia që edhe shoqëruesi i tyre mashkull të gëzojë të drejtën e të genit i mbrojtur, ndalja e shkëmbimit të pushkëve të gjakut në prezencë të femrave apo mundësia e tyre për të dalë të lira e kanë entuziazmuar diplomatin francez, po aq sa ç’e ka trishtuar injanca, pasojat e së cilës ndihen në të gjithë strukturën social-kulturore të shoqërisë shqiptare: “*Injanca e grave është shkëmbi ku ngecin e thyhen të gjitha përpjekjet për qytetërimin apo përmirësimin e të krishterëve shqiptar...Nëse femrat nuk arsimohen do të ngrihen kështjella rëre*”.

Ende sot, një pjesë e rëndësishme e diskutimeve gjinore vërtiten rreth roleve të ngulitura të gjinive me të cilat lindim e i kultivojmë më tej në jetën e përditshme, sa duhen konservuar e sa duhet të ndërveprojnë ato me njëra tjetrën, në mënyrë që të liberalizohen kufijtë që i ndajnë gjinitë, për t’i hapur rrugën mundësive të barabarta. Rezistenca për t’i

ndryshuar rolet e paracaktuara në shoqëri shpesh herë merr formën e antimoralit shoqëror, cenimi i të cilit është i ndëshkueshëm dhe me pasoja për atë që e ndërmerr. Një kontekst të tillë Hekard e sjell shumë natyrshëm ndërsa përmbyll përshkrimin mbi ceremonialin e martesës: *“Këto ceremoni janë fund e krye vetëm një komedi e gjatë, një komedi e mundimshme për vajzën e re, e mësuar, gjithsesi, qysh prej fëmijërisë, që të luajë rolin që i është paracaktuar dhe nga i cili nuk mund të heqë dorë pa u turpëruar e pa u konsideruar si e shthurur”* (Hecquard, 2008: 283).

Dhe megjithatë, sipas Hekardit, gruaja mund të ndikojë jashtëzakonisht në mënyrë të tërthortë përmes strukturave të tjera sociale, që rezultojnë edhe më të forta se vetë bashkëshorti. Këto janë familja dhe roli i saj riprodhues, po edhe këtu ndikimi i saj është shumëfish i djemve që ajo sjell në jetë: *“Edhe pse shqiptarët janë indiferente ndaj joshjeve të dashurisë, në asnjë vend tjetër gratë nuk gëzojnë një respekt të tillë dhe nuk kanë një ndikim kaq të fuqishëm.... Gruaja, nënë e shumë djemve, gëzon respektin e të gjithë familjes dhe ka një autoritet të madh mbi burrin e saj, i cili i detyrohet me lumturinë e ditëve të pleqërisë..., gratë shqiptare sillen shumë mirë me fëmijët e tyre dhe në mënyrë të veçantë me djemtë të cilëve iu bëhen skllave”* (Hecquard, 2008: 306).

Në shoqëritë patriarkale, femra me t'u martuar merr edhe rolin e saj si grua e shtëpisë, rol të cilin nuk e humb edhe nëse i vdes bashkëshorti, pasi vendin e tij në krah të vejushës mund ta marrë i vëllai (pa pyetur për pëlqimin e saj). Gjithsesi marrëdhënia e saj me bashkëshortin nuk është një akt publik shpirtëror, gjë që siç shprehet Hekarti, është kreyt në kundërshtim me zakonet e vendit nga ai vjen: *“Kurrë një grua nuk del në publik në krah të burrit të saj. Nëse ai do largohet, ajo nuk e përcjell dhe fshihet kur ai kthehet. Sado i gjatë të jetë një udhëtim, ajo kurrë nuk duhet të kërkojë lajme prej tij”* (Hecquard, 2008: 306). Ai e justifikon këtë qëndrim me luftërat e shumta të cilat duheshin përballuar me zemër të fortë. Të njëjtën panoramë na sjellë Kazanzaqi, në romanin e tij *Ja Vdekje, Ja Liri*, në figurën e Kapiten Mihailit, udhëheqësit të Revolucionit në Kretë, gjë që dëshmon se historia mund të diktojë edhe kulturë e më pas të dyja shkrihen në një.

Në kodet dhe doket zakonore, femra konsiderohet edhe si subjekt ekonomik apo e mirë materiale. Është i njohur zakoni i çmimit që u vihej vajzave në rast martesë nga 500-800 piastra turke (në kohën e Hekardit), por një traditë e tillë gjithsesi nuk është vetëm shqiptare. Ajo, që vajza sjellë me vetë apo fitohet edhe gjatë martesës prej të afërmeve, i përket gruas dhe nuk mund të preket nga i shoqi pa pëlqimin e saj. Por kjo është e gjitha, trashëgimia transmetohet

në vijë mashkullore dhe gratë nuk përfshihen në të, maksimumi ato gëzojnë të drejtën e përdorimit (në disa raste), por jo të zotërimit të pasurisë (Hecquard, 2008: 346). Mirëpo mungesa e të drejtës së trashëgimisë, nuk e përjashton gruan nga qerthulli i ndikimit të rangut ekonomik së cilit ajo i përket (përndryshe mungesa e të drejtave nuk e zhvesh nga detyrimet), kështu numri i qëndismave, veshjeve që ajo duhet të dërgojë tek i shoqi përcaktohen me ligj sipas klasës së cilës i përket familja. Rangu social për femrën ngelet dominues krahasimisht me atë ekonomik apo mes tyre ekzistojnë marrëdhënie ndërvarësie, të cilat i japin gruas të drejta sociale duke e pozicionuar brenda një klase të caktuar, pa të drejta ekonomike.

Një prej kontributeve të diplomatit francez është edhe regjistrimi i gjendjes së toponimisë shqiptare në shekullin e XIX, ku autori përpiqet të japë argumente që më së shumti vijnë përmes gojëdhënave. Një pjesë e këtyre argumenteve lidhen me rrëfenja që kanë në qendër femrën, të tilla janë gojëdhënat që shpjegojnë krijimin e fisit të Kelmendit dhe Kastratit. Kështu besohet që themeluesi i Fisit të Kelmendit (citohet nga autori shpjegimi i At Gabrielit) të jetë një mërgimtar, italian venedikas, i cili quhej Klement dhe që pat braktisur ndofta Dalmacinë, ndofta Hercegovinën për t'u strehuar në Shqipëri. Klementi jetonte në një vend të quajtur Moraç ku shërbente si ndihmës famullitar. I lodhur nga famullitari, ai merr rrugën e mbërrin në Tamara, ndërsa që nisur për në Shkodër për të shërbyer në ndonjë familje. Bariu që e takoi rrugës vendosi ta merrte në shtëpinë e tij për t'i ruajtur bagëtitë. Ai kishte një vajza Bubcen, të shëmtuar e çalamane, e cila filloi ta joshte. Dashuria e dy të rinjve, ra në sy të bariut, i cili duke i mallkuar të dy, i dëboi pasi u dha disa bagëti dhe trojet e Bistanit. Në gojëdhënë kanë ngelur dy fëmijët e tyre Abati N'dovi dhe Boga. Nga N'dovi lindën tre fëmijë: themeluesi i Selcës, i Vuklit, Nikcit. Nga djali i dytë rrjedh fisi i vogël i Bogës që bën pjesë në fisin e kelmendasve. E ngjashme është edhe gojëdhëna e fisit të Kastratit, që ka në qendër sërisht një emigrant Dedalin dhe vajzën e shkuar në moshë e të shëmtuar të një malësori nga Veleçiku.

Interesant është fakti se në gjenezë të toponimisë, ku vërtitet jetesa e këtyre dy fiseve nga më të përmendurat në malësitë shqiptare, vihet marrëdhënia e një emigranti ardhacak që tradhton besimin e bamirësit të tij, duke iu dorëzuar joshjeve të vajzës së shëmtuar, gjysmake, të pashpresë. Pa gjykuar mbi vërtetësinë e këtyre gojëdhanave, vitaliteti i femrës malësore që ngrihet nga hiçi duke qënësuar një fis të

tërë, është mbresëlënës dhe në koherencë me figurën e fortë të femrës malësore.

Ndërsa vëzhgon a analizon jetën e femrës shqiptare, Nowlle Roger, mban qëndrim kritik ndaj vlerave dhe moralit perëndimorë duke parë me simpati mentalitetin, mënyrën e jetesës dhe zakonet me të cilat është e mbrujtur jeta e femrës shqiptare. Ja se si na e përcjellë ajo psh kontrastin e vajzës shkodrane me atë perëndimore: *“Është aq e thjeshtë dhe aq e emocionuar dhe aq e ndryshme nga femrat e reja të Perëndimit, të cilave kontakti i vazhdueshëm me botën i detyron të përdorin një mori frazash shabllone, banalitete të shprehura bukur, për të mos shprehur ndjenjat e tyre të sinqerta. Sa shumë humbasin ndjenjat e tyre nga intensiteti i vet, duke u përpëlitur parreshur në vorbullën dhe argëtimin e jetës moderne”* (Roger, 2008: 27).

Marrëdhëniet ndërjetare të përshkuara brenda suazës së botës femërore ushqejnë kuadrin e njohur të harmonisë fetare, por edhe të një ndërveprimi, i cili me të drejtë është konsideruar unikal: *“Ndodh madje që myslimanët të martohen me gra të krishtera dhe të krishterët me gra myslimane. Ndodh gjithashtu që në gjirin e së njëjtës familje të ketë edhe të krishterë, edhe myslimanë dhe e njëjta ëmbëlsirë gatuhet gjysma me vaj për të krishterët që mbajnë kreshmë dhe gjysma tjetër me gjalp për myslimanët. Pra është një ëmbëlsirë feste që kthehet në një simbol”* (Roger, 2008: 60).

Me kuriozitet Nowll i futet më thellë marrëdhënieve dhe mënyrës së jetesës së grave që i përkasin dy besimeve dhe konstaton se: *“Të krishterët dhe myslimanët shqiptarë jetojnë pranë njëri-tjetrit dhe kanë zakone të ngjashme. Zakonet e njëres palë kanë ndikuar mbi zakonet e palës tjetër. Gratë e krishtera bëjnë një jetë të tërhequr nën mbikqyrje tepër të ngjashme me atë të grave muhamedane. Fakti që disa prej tyre shkojnë në kishë dhe të tjerat në xhami nuk duhet të na bëjnë të përfytyrojmë se ata e urrenin njëri tjetrin* (Roger, 2008: 33).

Në shkrimet e Roger gjejmë të dokumentuar edhe fakte që dëshmojnë për angazhimin publik e civil të gruas shqiptare. Në udhëtimin e saj në Korçë, autorja na flet për një shoqatë zonjash të quajtur *Rilindja*, e cila ka një qëllim të dyfishtë, kulturor dhe filantropik, ku bëjnë pjesë gra të krishtera e myslimane, kryesuar po nga një zonjë. Vetë Roger kishte marrë pjesë në një mbledhje të shoqatës ku flitej për ankimin e Shqipërisë së kërcënuar dhe dëshirën e pafund për qytetërim dhe përparim. Ashtu siç na i përshkruan autorja, gratë e Korçës, përziheshin me burra në krettime publike, ishin të veshura “alla evropiançe” dhe të krijoheshin ndjesia *“sikur ndodheshim në një prej salloneve të vendit tonë, por ku ruhej heshtja e një lloj qëndrimi i*

përmbajtur, ku mungonin pëshpërimat dhe të gajasurat” (Roger, 2008: 85).

Por kjo simpati nuk i shpëton realitetit: të qenit e gruas funksion, e zhveshë marrëdhënien burrë-grua, nga ndjenja e natyrshme mashkull-femër, duke e natyralizuar atë në kufijtë e detyrës, e cila është fort mirë e përcaktuar në rregulla e zakone që trashëgohen brez pas brezi e që si të tilla janë të shenjta. Historia e gruas 20 vjeçare nga Tirana, që ka vuar të dashurin e zemrës për të ruajtur nderin e saj si bashkëshorte e një burri që tashmë edhe ky ka rënë në luftë, është rrëqethëse *“...Kjo grua thua jse fëmijë, e cila nuk ishte aspak romantike dhe nuk kërkonte ndjenjat e rralla apo brerjet perverse të ndërgjegjes, pa kërkuar të drejtën e saj për kënaqësitë e jetës, befaz u kujtua se ishte gruaja e dikujt tjetër”* (Roger, 2008: 52).

Në një kuptim bota primitive shqiptare i ka shërbyer analistes si një pasqyrë ku perëndimi sheh vetveten me të mirat e të këqijat e zhvillimit. A s’duhet të bëjmë edhe ne të njëjtën gjë?

„Librat mbi Shqipërinë janë të rralla dhe aq më tepër shkrime udhëtimi. Të paktë janë ata që vizitojnë vendin tonë dhe që zbatimin me të shënuar ç’shohin dhe ç’vërejnë. Nga ana tjetër ne kemi nevojë të madhe të dijme ç’mejton ay që vjen së largu, rritur e rrojtur në një mjedis të ndryshëm prej tonit: ç’ide formon për ne dhe ç’përshtypje merr prej nesh. Njih vetveten, ka qenë fjala e të urtëve të çdo epoke dhe pasqyra më e mirë është gjykimi i tjetrit: atje do ta shihim dhe do ta njohim veten tonë lakuriq” (Skendo, 1999: 77), - kështu këshillonte Skëndo. Në fakt, bota ende e virgjër që na prezantonte Rogger, rreth një shekull më parë, sigurisht ka ndryshuar. Bashkë me të është transformuar edhe femra shqiptare. Por nevoja për të njohur veten e për t’u vetë korrigjuar ka ngelur aty, si një parakusht për zhvillim e emancipim..

Bibliografia

- BARTHOLDY, L. S. (1807), *Udhëtim në Greqi bërë në vitet 1803 dhe 1804*, Paris.
- BOUË, Ami (1840), *Turqia Evropiane*, Paris.
- GORDON, Jon (1927), *Dy vagabondë në Shqipëri*, Londër.
- HECQUARD, Hyacinthe (2008), *Historia dhe Pwrshkrimi i Shqipërisë së Epërme ose i Gegërisë, konsull francez në Shkodër*, Tiranë.
- HECQUARD, Hyacinthe (2008), *Historia dhe Përshkrimi i Shqipërisë së Epërme ose i Gegërisë, konsull francez në Shkodër*, Tiranë.
- HOBHOUSE, Joh C. (1813), *Udhëtim për në Kostandinopojë, përmes Shqipërisë dhe provincave të tjera të Turqisë në Evropë dhe në Azi gjatë viteve 1809-1810*, Londër.

Karakaçi

HUGHES, Smart (1820), *Udhëtime në Sicili, në Greqi dhe Shqipëri*, Londër.

ROGER, Nowlle (2008), *Nëpër Udhët e Shqipërisë* u përgatit nga Ilda Poda, Tiranë.

SKËNDO, Lumo (1927), *Diturija*, nr.1, f.24-32/f.89

SKENDO, Lumo (1999), *Udhëtarët e huaj në Shqipëri gjer në fund të shekullit XIX*, Eurorilindja, Tiranë.